

KONFERENCA SHKENCORE “MENDJE TË NDRITURA TË KULTURËS SHQIPTARE ANTON XANONI DHE JUSTIN RROTA”

Në 19 dhjetor 2014 në Shkodër, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Instituti i Studimeve Albanologjike, zhvilluan Konferencën shkencore “Mendje të ndritura të kulturës shqiptare Anton Xanoni dhe Justin Rrota”. Organizimi i saj u bë i mundur me mbështetjen e Konsullatës Austriake të Nderit. Në këtë konferencë morën pjesë studiues të njohur e të rinj nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Instituti i Studimeve Albanologjike, Qendra e Studimeve Albanologjike, Universiteti i Tiranës etj., të cilët nxorën e pah kontributin e shumanshëm Anton Xanonit dhe Justin Rrotës, si dhe diskutuan mbi problematikën e detyrat që shtrën në të ardhmen puna e këtyre dy mendjeve të ndritura të kulturës sonë.

Gjatë tre seancave të kësaj konference u mbajtën kumtesat: “Justin Rrota gjuhëtar i shquar i shekullit të kaluar” nga Tomor Osmani; “Justin Rrota, ndër të parët studiues të letërsisë shqipe” nga Fatbardha Hoxha; “Kontributi i Justin Rrotës për etimologjinë e shqipes” nga Kolec Topalli; “Rrota e Xanoni- dy prijtarë ndjellmirë të shqipes e shqiptarisë” nga Gjovalin Shkurta; “Çaste nga jeta, formimi arsimor e kulturor, si dhe kontributi

pedagogjik i Anton Maria Xanonit” nga Mimoza Priku & Tefë Topalli; “Koncepte historishkruese tek *Letratyra shqype* e Justin Rrotës” nga Erarba Çiraku, Ymer Çiraku; “Vëzhgime për letërsinë biblike të Xanoni” nga Nikë Ukgjini; “Justin Rrota, gjurmues i teksteve të vjetra shqipe” nga Evalda Paci; “Dy poezi të Fishtës për Xanonin” nga Alfred Çapaliku; “Justin Rrota *Letratyra Shqype* - një tekst historiko-letrar e didaktik” nga Eleni Karamitri; “Justin Rrota për alfabetin e shqipes” nga Mimoza Gjokutaj; “Krijimtaria letrare e Xanonit dhe mjeshtëria e tij përktimore” nga Elindë Dibra; “Anton Xanoni dhe Kolegji Saverian” Lindita Kazazi & Njazi Kazazi; “Mbi kriteret e klasifikimit të gjymtyrëve të fjalisë në sintaksën e Justin Rrotës” nga Anila Kananaj; “Fjali e thjeshtë e përbërë në tekstin “*Sintaksi i shqipes* i Justin Rrotës” nga Bora Logu; “Përmbledhje me proza *Rreth votrës* e Justin Rrotës ndërmjet tekstit original letrar, përshtatjes, tekstit didaktik dhe publicistik” nga Arben Prendi; “Reflektime të sotme mbi disa çështje didaktike të *Prisin' lamë t' Letratyrës*” nga Ermira Alia & Vinçens Marku; “Çështje leksikore të gjuhës shqipe në gramatikën e Justin Rrotës” nga Juliana Kume;

“Elemente të gjuhësisë së përgjithshme në veprën e Justin Rrotës” nga Rrezarta Draçini; “Dy variantet e botuara të Letratyra Shqype” nga Vjollca Osja; “Roli i foljes në organizimin e fjalisë sipas këndvështrimin të Justin Rrotës” nga Flora Koleci; “Status i formave të pashtjelluara të sintaksa e Justin Rrotës, krahasuar me trajtimet e sotme” nga Rozana Rushiti & Adriana Dervishaj; “Prije mbidialektore në prozën letrare të Justin Rrotës” nga Anisa Kosteri & Zamira Shkreli; “Ndërtime e kuptime foljore në veprën *Rreth votrës* të Justin Rrotës” nga Aida Uruçi; “Konceptime sociolinguistike në shkrimet e Atë Justin Rrotës” nga

Merita Hysa; “Mendimi i Justin Rrotës për historinë e gjuhës shqipe dhe atë indoevropiane” nga Erzen Koperaj; “Çështje të politikave gjuhësore të trajtuara tek Justin Rrota” nga Rezearta Murati; “Anton Xanoni për mësimin e gjuhës shqipe” nga Irida Hoti dhe “Rreth pjesëzës së hershme toske *tuke* si pjesë e formës analitike të tipit *duke punuar*” nga Monika Hasani.

Tematika dhe problematika e gjerë që u trajtua nga studiueset gjatë tre seancave të konferencës, dhanë mundësi për shkëmbime idesh e mendimesh, sidomos nëpërmjet diskutimeve që ngjallën kumtesat.

Anila KANANAJ